



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

A project for Albania funded by the European Union

Projekt

LIGJ

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9587, DATË 20.7.2006 “PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT” TË NDRYSHUAR*

Draft 2

Versioni 1

7 Nëntor 2013

* Ky ligj përfaqëson pjesërisht:

1. Direktivën 92/43/EEC mbi ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër, të ndryshuar nga direktiva 97/62/EC, direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003 (FZ L 206, 22.7.1992, fq. 7);
2. Direktivën 2009/147/EC për ruajtjen e shpendëve të egër (FZ L20/7, 20.1.2010.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. _____, datë _____

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9587, DATË 20.7.2006 “PËR
MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT” TË NDRYSHUAR”***

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

* Ky ligj përshron pjesërisht:

3. Direktivën 92/43/EEC mbi ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër, të ndryshuar nga direktiva 97/62/EC, direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003 (FZ L 206, 22.7.1992, p. 7);
4. Direktivën 2009/147/EC për ruajtjen e shpendëve të egër (FZ L20/7, 20.1.2010.)

3. Të sigurojë ngritjen e rrjetit për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër në territorin e Republikës së Shqipërisë;
4. Të përcaktojë masa për të mbajtur ose rimëkëmbur në një status të favorshëm ruajtje habitatat natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë me interes për Komunitetin Evropian;
5. Të sigurojë një manaxhim të balancuar të biodiversitetit, duke marrë në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale, kulturore, si dhe karakteristikat rajonale.

Neni 2

Në nenin 2, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:
“leje mjedisi” janë përkatësisht lejet e mjedisit të tipit A, B ose C sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.
2. Pika 35, ndryshohet si më poshtë:
“Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.”
3. Pika 36 ndryshohet si më poshtë:
“Ministër” është ministri përgjegjës për mjedisin.”
4. Pika 37, shfuqizohet.
5. Pas pikës 42 shtohen pikat 43, 44, 45, 46 dhe 47 me këto përmbajtje:
 43. **“Njësitë e Qeverisjes Vendore”** kanë të njëjtin kuptim të dhënë sipas Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar;
 44. **“Natyra 2000”** është rrjeti ekologjik i zonave të mbrojtura, i ngritur për të siguruar mbijetesën e habitateve dhe llojeve më me vlerë të Evropës;
 45. **“Zonë me interes për Komunitetin Evropian”** është zona e cila në rajonet biogeografike ose në rajonet të cilave i përket, kontribuon dukshëm në ruajtjen ose rimëkëmbjen në një status të favorshëm ruajtje të një tipi habitati natyror ose lloji, që mund të kontribuojë dukshëm në lidhje me rrjetin “Natyra 2000” dhe/ose kontribuon dukshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik brenda rajonit biogeografik ose rajoneve në fjalë;
 46. **“Zonë e veçantë ruajtje”** ka të njëjtin kuptim të dhënë sipas Ligjit nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, date 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”;
 47. **“Zonë e veçantë mbrojtje”** është zona ku shpendët e egër klasifikohen si të rrallë dhe të prekshëm dhe si rregull i përkasin llojeve migratore që janë të mbrojtura në mënyrë strikte.

Neni 3

Në nenin 3, pika 1, shkronja “a” pas togfjalëshit “..pronë shtetërore apo private” shtohet togfjalëshi “veçanërisht në Rrjetin Përfaqësues të Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë.”

Neni 4

Në nenin 5, titulli “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me titullin “Ministria e Mjedisit”.

Neni 5

Kudo në ligj emërtimi “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.

Neni 6

Në nenin 16, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 pas togfjalëshit “...hartojnë planet e menaxhimit..” shtohet togfjalëshi “dhe planet e veprimt..”.
2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:
“1.1 Kriteret minimale për planet e menaxhimit të ekosistemeve, habitateve dhe peisazheve që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura përcaktohen me udhëzim të Ministrit.”

Neni 7

Pas Kreut IV shtohet Kreu IV/I “Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tipeve të habitateve natyrore, kafshëve përfshirë shpendët e egër, si dhe llojet e bimëve me interes për Komunitetin Evropian”.

Neni 8

Pas nenit 17, shtohet nenet 17/1, 17/2, 17/3, 17/4 dhe 17/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Ruajtja e habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

1. Përveç sa parashikohet në Ligjin nr.9868, date 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, zonat e veçanta të ruajtjes që përfshijnë zonat me habitat natyror referuar në nenin 17/4, shkronja “a” dhe habitatet e llojeve referuar në nenin 17/4, shkronja “b”, si dhe zonat e veçanta të mbrojtura për shpendët e egër referuar në nenin 17/4, shkronja “e” të këtij ligji duhet të përcaktohen për të kontribuar në krijimin e rrjetit ekologjik koherent Evropian.
2. Në vijim të dispozitave të parashikuara në nenin 4/3 dhe 7 të Ligjit nr.9868, date 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, si

dhe neneve 27, 28, 29, 30, 31 të Ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” ngrihet rrjeti ekologjik bashkëkohor “Natyra 2000”, i zonave të veçanta ruajtjeje dhe zonave të veçanta mbrojtjeje.

“Neni 17/2

Përcaktimi dhe menaxhimi i habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

1. Ministria përzgjedh një listë të zonave me interes për Komunitetin Evropian, duke identifikuar dukuritë e tipeve të habitateve referuar në nenin 17/4, shkronja “a” dhe llojet referuar në nenin 17/4, shkronja “b” në çdo rajon të tij biogjeografik me qëllim propozimin Komisionit Evropian të listës së zonave të cilat strehojnë këto tipe habitatesh dhe llojesh. Lista kombëtare e zonave me interes për Komunitetin Evropian së bashku me një përshkrim të tipareve karakteristike të zonave specifike përgatitet në përputhje me Formatin Standard të të Dhënave të parashikuar në VKM 897, datë 21.12.2011 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes”.
2. Ministria mbikëqyr statusin e ruajtjes së habitateve natyrore dhe llojeve, referuar në nenin 17/4, shkronja “c” duke i kushtuar vëmendje të veçantë habitateve natyrore përparësore, llojeve përparësore si dhe nxit kërkimet dhe punën shkencore me qëllim arritjen e objektivave.
3. Ministria krijon sistemin e monitorimit për kapjen e rastësishme dhe vrasjen e llojeve referuar në nenin 17/4, shkronja “c”, kryen kërkime të mëtejshme ose merr masa për ruajtjen sic kërkohet duke shmangur impaktin negativë të dukshëm për llojet në fjalë.
4. Ministri përcakton me udhëzim masat përfshirë mbikqyrjen e vazhdueshme për të siguruar që marrja në gjëndje të egër dhe/ose shfrytëzimi i llojeve referuar në nenin 17/4, shkronja “d” mund të jetë objekt i masave menaxhuese dhe është në përputhje me mbajtjen e statusit të favorshëm të ruajtjes së tyre.
5. Ministri miraton me urdhër listën e zonave të veçanta mbrojtjeje duke identifikuar zonat përkatëse për të siguruar mbrojtjen e llojeve kombëtare në përputhje me nenin 17/4, shkronja “e”.

Neni 17/3

Masa shoqëruese

Ministria:

- a) merr të gjitha masat e nevojshëm dhe të përshtatshme për të shmangur dëmtimin dhe/ose shqetësimin e habitateve natyrore, habitateve të llojeve në zona të veçanta ruajtjeje, si dhe të shpendëve të egër në zona të veçanta mbrojtjeje;
- b) lidh marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet përkatëse ndërkombëtare përfshirë organizatat jo fitimprurëse për të siguruar zbatimin efektiv të këtij Kreu;

- c) siguron që informacioni i transmetuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për statusin e ruajtjes së natyrës të shqyrtohet në mënyrën e duhur;
- d) siguron që procedurat në lidhje me përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes të jenë të thjeshta dhe të shpejta me qëllim nxitjen e krijimit të zonave të mbrojtura;
- e) siguron në përputhje me legjislacionin në fuqi se çdo palë e përfshirë në çështjet për natyrën të kontribuojë në ruajtjen dhe rimëkëmbjen e statusit duke kryer sipas rastit edhe procedurat ligjore për kompesim për shkaktim dëmi.

Neni 17/4

Listat e tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve.

Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit miraton:

- a. Listën e tipeve të habitateve natyrore me interes për Komunitetin Evropian ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta ruajtje;
- b. Listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për Komunitetin Evropian ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta ruajtjeje;
- c. Listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për Komunitetin Evropian në nevojë për mbrojtje strikte;
- d. Listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për Komunitetin Evropian marrja e të cilave në gjëndje të egër dhe shfrytëzimi mund të jetë objekt i masave menaxhuese;
- e. Listën e llojeve të brishtë të shpendëve që kanë nevojë për masa të veçanta ruajtje;
- f. Parimet e identifikimit të llojeve që do të jenë objekt kërkimesh për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër.

Neni 17/5

Raportimi

1. Ministria përgatit në çdo 6 vjet raportin mbi zbatimin e masave të marra nën këtë Kre. Ky raport përfshin veçanërisht masat ruajtëse referuar në nenin 17/2 dhe 17/3, një vlerësim të impaktit të këtyre masave për ruajtjen e statusit të tipeve të habitateve natyrore të shkronjës “a” dhe të llojeve të shkronjës “b” të nenit 17/4, si dhe rezultatet kryesore të mbikqyrjes referuar në nenin 17/2, pika 4. Ky raport bëhet i disponueshëm për publikun.
2. Ministri përcakton me urdhër formatin që do të përdoret për hartimin e raportit.

Neni 9

Në nenin 26, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Ministri përcakton me udhëzim kriteret minimale për planet e menaxhimit të habitateve të llojeve veçanërisht të mbrojtura.”

Neni 10

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri përgjegjës për mjedisin për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

ILIR META